



23 prill 2018

**Dita Ndërkombëtare e Tokës: 10 Propozime Politikash të cilat Kosova mund t'i
Ndërmarrë drejt Ruajtjes së Burimeve Tokësore!**

Dita ndërkombëtare e Tokës e gjenë Kosovën si njëren nga vendet që për fat të keq i kontribuon gjendjes jo të mirë të planetit. Edhe pse me territor të vogël, Kosova mund të tregoj që e ka seriozisht mbrojtjen e tokës duke ndërmarrë disa masa të menjëhershme. Masat do të përfshinin fuqizim të bazës rregullative dhe institucionale, prioritizim të zgjidhjes së problemeve dhe masa të matshme e të menjëhershme për të përmirësuar kualitetin e mjedisit në Kosovë. Ja dhjetë masa që duhen ndërmarrë menjëherë në mënyrë që shënimi i Ditës së Tokës të mos jetë simbolik por të konkretizohet me masa dhe vendime të dobishme për Tokën:

1. Zbatimi i plotë i Strategjisë për Ndryshime Klimatike 2014 – 2024 dhe Planit Kombëtar për Reduktim të Emisioneve

Nevojitet një vlerësim urgjent i Strategjisë për Ndryshime Klimatike 2014 – 2024 dhe planit të veprimit. Një pjesë shumë e madhe e masave të përfshira në këto dokumente nuk janë zbatuar. Kosova ende nuk ka themeluar Ekofondin, nuk ka bërë pothuaj asgjë në përmirësimin e përdorimit racional të resurseve natyrore dhe madje nuk ka përditësuar as legjislacionin në fushën e efikasitetit të energjisë. Raporti i fundit të BE-së alarmon për nevojën që të ketë më shumë përpjekje për përmirësim të standardeve të emetimeve për vetura, kualitet të karburanteve, depozitimi gjeologjik i CO₂, përdorimit të tokës, pyllëzimit, substancave që zvogëlojnë ozonin dhe gazrave të fluoruar. Të gjitha këto, kërkojnë rishikim të menjëhershëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe fillim të zbatimit të menjëhershëm të tyre.

2. Plan Kombëtar për Transformimin e Sistemit Energjetik

Në vend të prioritizimit të investimeve të dëmshme në kapacitete të linjtit, Kosova duhet të hartoj një Plan Kombëtar për Transformimin e Sistemit Energjetik deri në vitin 2050. Ky plan do të ishte në përputhje me përkushtimin dhe udhërrëfyesin e BE-së për dekarbonizim të plotë deri në vitin 2050. Është ekonomikisht e realizueshme dhe është jashtëzakonisht e mirëseardhur për tokën dhe kualitetin e jetës në përgjithësi. Transformimi i plotë i sistemit energjetik do të krijojë vende të reja dhe të gjelbra të punës, do të rrisë ekonominë vendore dhe do të përmirësoj ndjeshëm mjedisin dhe shëndetin publik.

3. Pastrim të mbetjeve radioaktive

Kosova ende nuk ka bërë pastrimin e mbetjeve radioaktive. Një proces i tillë duhet të ndodhë sa më parë që është e mundur në mënyrë që të ndalet kontaminimi i tokës, ujit dhe ajrit. Pastrimi i mbetjeve jo vetëm që do të përmirësonte kualitetin e tokës, por edhe do të ishte e domosdoshme për mbrojtje të shëndetit publik. Pastrimi i mjedisit radioaktiv do të ndihmonte në mbrojtjen e shëndetit publik duke evituar rrezikun që i kanoset tokës, ujit dhe ajrit të Kosovës.

4. Dyfishim të hapësirave të gjelbra në zona urbane

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me komunat duhet të shpallë dyfishimin e zonave të gjelbra nëpër secilën komunë të Republikës së Kosovës. Planet urbanistike dhe hartat zonale në komuna duhet të parashikojnë patjetër rrijten e hapësirave të gjelbra dhe ruajtjen e hapësirave ekzistuese nëpër zona urbane. Projekte për investime me mbjellje të “drunjëve të menqur” në zonat më kritike urbane duhet të mbështeten nga niveli qendror në bashkëpunim me komunat.

5. Rehabilitim të plotë të tokave

Një masë e menjëhershme që nevojitet të bëhet është rregullimi i tokave. Masat që përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore, rritjes së madhësisë së fermave, përmirësimit të infrastrukturës dhe zbatimin e masave agroteknike duhet të ndërmerren menjëherë. Në të njëjtën kohë, duhet bërë një rivlerësim i sistemeve aktuale të ujitjes dhe të ketë një monitorim të zbatimit të projekteve për rregullim të tokave. Përfundimisht, një regjistër online i gjendjes së tokave duhet të funksionalizohet në atë mënyrë që të gjithë akterët institucional dhe jointitucional të kenë informata në kohë reale mbi gjendjen e tokave dhe infrastrukturën përcjellëse dhe prioritetet për intervenim.

6. Mbrojtje ligjore për resurset ujore

Mbrojtja e resurseve ujore është një nga masat e menjëhershme që Kosova duhet të ndërmarrë. Nevojiten masa që parandalojnë kontaminimin e lumenjëve nga mbeturinat industriale, nga aktivitetet minerare dhe nga hedhja e mbeturinave të tjera. Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të identifikojë dhe mbroj resurset ujore edhe nga kontaminimi nëntokësor. Mbrojtja e ujit duhet të bëhet edhe përmes investimeve në rrjet dhe masave ligjore që promovojnë shfrytëzimin racional të ujit. Duhet urgjentisht të ndalohet faturimi paushall dhe të vendosen kontrole më të rrepta ndaj keqpërdoruesve të ujit.

7. Reformimi i Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave përfshin të gjitha aktivitetet prej mbledhjes, trajtimit, ripërdorimit, procesimit, riciklimit, dhe hedhjes përfundimtare të tyre. Me anë të këtyre aktivitetëve synohet reduktimi i nivelit të përgjithshëm të gjenerimit të mbeturinave me ç'rast do të parandalohen efektet potenciale negative të imponuara në mjedis dhe shëndetin publik. Andaj, në mënyrë që këto dy komponentë të mos cenohen është e nevojshme ndërmarrja e disa masave sa i përket mbeturinave, si p.sh. reformimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve me anë të së cilit duhet definuar saktë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit hisedarës që është ngushtë i kyçur në këtë sistem. Gjithashtu, duhet implementuar plotësisht ligji mbi mbeturinat, ku fokusi më i madh do i jepej aplikimit të gjobave. Implementimi i pjesshëm që po ndodh në komunitet vjen edhe si rezultat i kapaciteteve të ulëta të njësive të inspektorateve komunale të cilët e kanë të pamundur ushtrimin e detyrave të tyre, e në disa komuna problemi intensifikohet edhe më shumë pasi këto njësi nuk janë fare funksionale.

8. Mbrojtja e Pyjeve

Shpyllëzimi është bërë mjaft i zakonshëm viteve të fundit në të gjithë Kosovën. Në njërin anë, mungesa e koordinimit dhe prioritizimit institucional, e në anën tjetër nivel i zhvillimit ekonomik kanë bërë që gjendja e pyjeve të jetë larg të dëshiruarës. Përderisa kjo çështje nuk është e listuar ndër të parat në agjendat kombëtare, dhe në mënyrë që gjendja të stabilizohet hapat të cilat qeveria e Kosovës mund të ndërmarrë janë rishikimi i strategjisë kombëtare të pyjeve dhe e kategorizimit të resurseve pyjore, përditësimi periodik i statistikave të pyjeve, definimi i një koeficienti kombëtar të përdorimit të drurit, transformimi i mënyrës së ngrohjes, çertifitkim i prerësve të drurit dhe vendosja e kufizimeve, zero shpyllëzim, promovimi i shitjes dhe zbatimi i sistemit të standardeve ISO 14001 mbi menaxhimit mjedisor, ndërlikime të industrisë së drurit për menaxhim të qëndrueshëm, si dhe mbrojtje e biodiversitetit në pyje.

9. Shtrirja e Shtigjeve të Çiklizmit

Përderisa planeti Tokë është duke u përballur me nivel të lartë të emisioneve CO₂ për një kohë të gjatë tani, ka mënyra të ndryshme që komunitetet dhe individët të kontribuojnë për një mjedis më të pastër. Institucionet të niveleve lokale mund të rrisin investimet në shtrirjen e shtigjeve për çiklizim brenda

qyteteve. Për më tepër, në lokacione të caktuara brenda qyteteve mund të vendosen shtëpiza ku anëtarët e komunitetit mund të marrin me qera biçikleta të cilat do të mund t'i përdornin gjatë gjithë ditës. Kjo do t'i ndihmonte jashtë mase jo vetëm krijimit të një ambienti të dëshirueshëm për të jetuar në të, por edhe ngritjes së vetëdijesimit të qytetarëve dhe përmirësimit të shëndetit të tyre publik.

10. Edukimi i Komunitetit mbi Mbrojtjen e Tokës

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, është edhe masa e fundit mbi edukimin e komunitetit rreth përfitimeve që vinë nga mbrojtja e planetit Tokë. Ky vetëdijesim mund të marrë forma të ndryshme për çështje mjedisore specifike. Në ditë të caktuara botërore rreth problematikave mjedisore mund të organizohen aktivitete të ndryshme që përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve. Përveç kësaj autoritetet lokale mund të promovojnë koncepte të shumta, si psh. nëse flasim për menaxhimin e mbeturinave një koncept mjaft i përmendur është ai i reduktimit, ripërdorimit, riciklimit¹. Ky koncept synon edukimin e komunitetit duke theksuar përfitimet që vinë nga ripërdorimi i produkteve, qofshin edhe ato elektronike, dhe riciklimi i mbetjeve të tyre. Kjo përpos që do të ndihmonte mjedisin, do të favorizonte edhe individët duke bërë që ata të kursejnë nga të ardhurat e tyre. Gjithashtu, nëse rikthehemi tek çështja e gazrave serrë, një opsion që do të ndihmonte në përmirësimin e situatës është edhe fuqizimi i transportit publik dhe të përbashkët².

¹ Reduce, Reuse, Recycle

² Carpooling